



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 22 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të datës 11 gusht 2000, nenit 19 dhe të nenit 40, par.3.III. të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2005 merr

V E N D I M

PËR RITHEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE “HORTIKULTURA” NË PRISHTINË

Neni 1

Rithemelohet ndërmarrja publike komunale “Hortikultura” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: NPK “Hortikultura”).

Neni 2

Qëllimi i rithemelimit të NPK, nga neni 1 i këtij Vendimi, është rregullimi dhe udhëheqja më e lehtë e çështjeve publike nga Komuna e Prishtinës për territorin e saj.

Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e deleguara nga Komuna në ndërmarrjen e themeluar sipas këtij Vendimi, do të përcaktohen me statutin dhe aktet tjera normative të kësaj ndërmarrje.

Neni 3

NPK “Hortikultura” do të nxjerrë Statutin dhe aktet tjera normative për punën dhe organizimin e saj.

Statuti dhe aktet tjera normative, nga al. 1 e këtij neni, do të miratohen nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Komuna kontrollon dhe mbikëqyr afarizmin financiar të NPK të themeluar sipas këtij Vendimi.

Për shërbimet publike të kryera nga ndërmarrja e themeluar sipas këtij Vendimi, Kuvendit të Komunës duhet t'i dorëzohet buxheti për miratim në fillim të muajt dhjetor, para çdo viti vijues fiskal.

Buxheti i propozuar, nga al. 2 të këtij neni, duhet të përfshijë llojin dhe lartësinë e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve.

Neni 5

E drejta e shfrytëzimit të paluajtshmërisë, e regjistruar në emër ish-NPK “Hortikultura” para miratimit të këtij Vendimi, do të kthehet në të drejtë të shfrytëzimit të Komunës së Prishtinës.

Bazë për ndryshimet e së drejtës, nga par.1 i këtij neni, në evidencat kadastrale, do të jetë ky Vendim.

Neni 6

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejë veprime procedurale nga përgjegjësia e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 7

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen të gjitha vendimet dhe aktet tjera të nxjerra nga ish-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me të cilat është themeluar kjo ish-ndërmarrje.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.33-659, më 29.12.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri